

DEMOKRACIA ËSHTË



KOMUNIKIM


NE, QYTETARË AKTIV NË KOSOVË

ELION (11), BARDH (10), LOREN (10), ANES (11), MIRANDA (10), RRON (11), REA (11), DELVINA (11)



Ne jemi shumë të lumtur që kemi mundësinë të jemi qytetarë të një vendi demokratik, siç është Kosova

Të gjithë ne jemi qytetarë të Kosovës sepse qytetar konsiderohet çdo person që jeton brenda kufijve të shtetit tonë. Megjithatë, ne si qytetarë kemi shumë të drejta. Me të drejta e dijmë që vijmë edhe përgjegjësitë. Këto të drejta na i mundëson forma më e mirë e qeverisjes, e që është demokracia. Disa nga të drejtat tona



janë: e drejta e arsimit, e drejta e të folurit lirshëm, e drejta e lojës, e drejta e identitetit, etj. Këto të drejta nuk njohin gjini, fe, racë apo komb. Kjo nënkupton se të gjithë qytetarët janë të barabartë në demokraci. Ne si fëmijë kemi shumë të drejta, por edhe ne kemi përgjegjësi. Marrim shembull, ne kemi përgjegjësi të mësojmë në shkollë, të jemi të respektueshëm ndaj njëri-tjetrit, t'i bëjmë detyrat, etj. Sikurse ne fëmijët që kemi të drejta si dhe përgjegjësi në shkollë edhe

prindërit tanë kanë përgjegjësi ndaj shtetit. Përgjegjësi e tyre është pagesa e taksave, pagesa e energjisë elektrike, nënshkrimi i peticioneve, pjesëmarrja në protesta paqësore, etj.

Kur të rritemi, edhe ne do t'i kemi këto përgjegjësi. Tani përgjegjësia jonë kryesore është shkollimi dhe mësimi. Megjithatë, ne gjithashtu mund të jemi aktiv në vendin tonë. Një shembull shumë i mirë i kësaj është sportistja Majlinda Kelmendi e cila ka bërë që vendi ynë të krenohet me të. Falë saj dhe përkushtimit që ajo ka treguar, ne kemi hyrë në Lojërat Olimpike. Sot shumë shtete Kosovën e njohin si një vend me të rinjë shumë të talentuar dhe që punojnë shumë për sukseset e tyre. Në të ardhmen edhe ne do të jemi një shembull i tillë. Secili anëtar i grupit tonë me profesionin që ka zgjedhur do të bëjë që Kosova të jetë një vend i mrekullueshëm.

Në këtë mënyrë ne do të jemi aktiv dhe do të jemi shembull për të tjerët.



Autorët e artikullit



Këtu kemi paraqitur disa nga llojet e mediave të cilat luajnë rol shumë të rëndësishëm në jetën tonë

**Kjo pjesë e artikullit tonë flet për mediat dhe rëndësinë e tyre në demokraci.
Lexoni më poshtë për t'u informuar më shumë rreth kësaj teme**

A e keni menduar ndonjëherë se si do ta dinim se çfarë po ndodh në Kuvend nëse mediat nuk do të kishin ekzistuar? Kjo është shumë e thjeshtë për t'u kuptuar, sepse pa media jeta jonë do të ishte më e komplikuar dhe do të jetonim në errësirë dhe pa informata. Për këtë arsye, media ka një rol të rëndësishëm në

jetën tonë. Në kohën e fushatave zgjedhore ne nuk do të mund të informoheshim për të gjitha planprogramet e kandidatëve për deputetë.

Ne si qytetarë kemi të drejtë të informohemi saktë dhe në mënyrë korrekte. Andaj, mediat kanë përgjegjësi që informatat të cilat i marrin të na i përçojnë drejt.



Ky libër, është një ndër librat më të dashur nga ne, sepse këtu janë të shkruara të gjitha të drejtat tona si fëmijë

KUVENDI I KOSOVËS

AMAR (11), JON (10), EMIR (11), LEDRI (11), RREZART (10), ERA (11), ISABELLA (11), HARISA (10)



Të dashur lexues, në këtë artikull do të mund të lexoni për Kuvendin e Kosovës dhe funksionet e tij. Lexim të mbarë!

Kuvendi i Republikës së Kosovës vazhdoi punën e tij në mënyrë të pavarur që nga data 17 shkurt 2008, atëherë kur u shpall Pavarësia e Kosovës. Në Punëtorinë e Demokracisë sot ne mësuam se Kuvendi i Kosovës ka gjithsej 120 deputetë, prej të cilëve 100 janë shqiptarë, kurse 10 të tjerë janë serbë, dhe 10 të tjerë janë deputetë të komuniteteve të ndryshme jo shumicë.



Gazetarët e ardhshëm të demokracisë

Çdo qytetar mbi moshën 18 vjeçare ka të drejtë të votoj për Kuvendin dhe të zgjedh deputetët. Kurse, deputetët e votojnë Kryeministrin, i cili e formon Qeverinë. Pastaj zgjedhin Kryetarin e Kuvendit dhe në fund ata zgjedhin Presidentin e Kosovës. Kuvendi i Kosovës ka tri funksione kryesore, e ato janë: funksioni përfaqësues, funksioni legjislativ dhe funksioni i kontrollit.

Çfarë janë këto funksione? Funksioni përfaqësues do të thotë se qytetarët votojnë për një kandidat. Pastaj, kur ai zgjedhet bëhet përfaqësues i qytetarëve dhe ai flet dhe merr vendime në emër të tyre. Këta përfaqësues janë deputetët. Funksioni legjislativ do të thotë se detyra e Kuvendit të Kosovës është të vë ligjet, sepse vetë fjala legjislativ do të thotë ligjvënës. Ndërsa, funksioni i kontrollit do të thotë se Kuvendi kontrollon punën e Qeverisë nëse ajo po i zbaton ligjet, e miratuara nga ligjvënësit.

Teksa ne mësuam sot për Kuvendin e Kosovës na u kujtua se edhe ne bëjmë zgjedhje në klasën tonë. Një ngjashmëri tjetër është se në klasën tonë ka vajza dhe djem, po ashtu edhe në Kuvend ka gra dhe burra deputetë. Nga njohuritë që morëm ne mësuam se puna e deputetëve është e rëndësishme dhe kërkon shumë përkushtim. Shpresojmë që një ditë të bëhemi edhe ne deputetë në të ardhmen. Faleminderit që lexuat artikullin tonë.



Deklarata e Betimit të deputetëve

ZGJEDHJET DEMOKRATIKE

ARION (10), ERDIN (10), ELDISA (11), DONAT (11), GENTA (10), RIGA (10), SUELA (10), YLLI (11)

ELDI (10)



Zgjedhjet janë demokratike kur zhvillohen në shoqëri demokratike

Zgjedhjet janë një ndër proceset që më së shpeshti ne si fëmijë i hasim në jetën tonë. Pra, ne jemi të lirë të zgjedhim kur kemi në dispozicion më shumë se një alternativë. Megjithatë, jo çdo herë mund të kemi


Këto ishin disa nga zgjedhjet tona të përditshmërisë. Ndërsa kur të rritemi dhe të arrijmë moshën 18 vjeçare mund të marrim pjesë dhe kontribuojmë në dy lloje të zgjedhjeve. Në zgjedhjet lokale ne do të mund të votojmë për kryetarin e komunës si dhe asambleistët. Ndërsa, në zgjedhjet qendrore apo parlamentare ne do të votojmë kandidatët për deputetë, të cilët janë në kuadër të partive të ndryshme politike. Zgjedhjet për qytetarët janë edhe përgjegjësi, sepse ne jemi përgjegjës për komunitetin ku jetojmë. Mesazhi ynë për ju, në lidhje me zgjedhjet demokratike është ky: çdo qytetar ka të drejtën e votës, andaj të dashur lexues ju ftojmë të votoni, sepse vota juaj mund të bëj ndryshim për të mirën e secilit. Unë vlej, andaj edhe vota ime vlen, por edhe ti i dashur lexues vlen.



mundësinë të zgjedhim. Sigurisht se është më mirë kur ke mundësi zgjedhjeje, pra ke më shumë se vetëm një alternativë. Kjo jo vetëm që na gëzon ne si fëmijë, por po ashtu edhe na e bën jetën tonë më të lehtë. Ne e menduam si shembull më të mirë për ta shpjeguar procesin zgjedhor, zgjedhjet që i bëjmë në klasën tonë. Kjo funksionon përmes votave dhe shprehjes së lirë të mendimit nga shokët dhe shoqet e klasës, sepse kryesia e klasës tonë është zgjedhur me votat tona. Ne, jemi të lirë të votojmë për atë person që mendojmë që është më i miri për këtë detyrë.



Puna e grupit „Rushi“



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Meto Bajraktari“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-5
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë